



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA URA VAJGURE
KESHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR 30 DATE 17/05/2016

MBI MIRATIMIN E VEND'DEPOZITIMIT TË MBETJEVE URBANE PËR BASHKINË URA VAJGURE

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 17/05/2016, referuar materialit të paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Investimeve, Kontrollit të Projekteve, Shërbimeve Publike dhe Strehimit, Sektori i Shërbimit Publik dhe Drejtoria e Asistencës së Fermerit dhe Mbrojtjes së Tokës në mbështetje të Ligjit Nr 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore", Ligjit Nr 107/2014 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar në zbatim të Ligjit Nr 10431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" si dhe Ligjit Nr 10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"

V e n d o s i:

Me 14 vota PRO nga 14 Këshilltarë prezentë:

I .Të miratojë venddepozitimin e mbetjeve urbane për Bashkinë Ura Vajgure, me Nr Pasurie 53/58, me sipërfaqe 13.4 ha, lloji i pasurisë ullishte sipas pritimit III "Lista e pasurive të paluajtshme sipas numrit të pasurisë" ndarë me Ligjin Nr 7501 datë 19.07.1991 "Për tokën", aktualisht rezulton tokë e pafrytshme, me pronar shtet, me zonë kadastrale zk 3813 e cila ndodhet në Territorin Administrativ të Bashkisë Ura Vajgure në fshatin Vokopolë .

Për konfirmim në Prefekturë
Sekretari i Këshillit Bashkiak
Elis Gjata



Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hysen Hoxha



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA URA VAJGURE
KESHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR 31 DATE 17/05/2016

MBI MIRATIMIN E VEND'DEPOZITIMIT TË MBETJEVE INERTE PËR BASHKINË URA VAJGURE

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 17/05/2016, referuar materialit të paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Investimeve, Kontrollit të Projekteve, Shërbimeve Publike dhe Strehimit, Sektori i Shërbimit Publik dhe Drejtoria e Asistencës së Fermerit dhe Mbrojtjes së Tokës në mbështetje të Ligjit Nr 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjit Nr 107/2014 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar, në zbatim të Ligjit Nr 10431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" si dhe Ligjit Nr 10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"

V e n d o s i :

Me 14 vota PRO nga 14 Këshilltarë prezentë:

I .Të miratojë venddepozitimin e mbetjeve inerte për Bashkinë Ura Vajgurore, me Nr Pasurie 9/133, me sipërfaqe 6226 m², me proanr shtet, me zonë kadastrale zk 3682 e cila ndodhet në Territorin Administrativ të Bashkisë Ura Vajgurore, në lagjen "28 Nentori"

Për konfirmim në Prefekturë
Sekretari i Këshillit Bashkiak
Elis Gjata



Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hysen Hoxha